



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:147590
Datë: 23.05.2022
Numri i dokumentit: 03040845

AC.nr.6770/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, me praktikanten e gjykatës Albana Kosova, në çështjen përmbarimore sipas propozimit për përmbarim të kreditores V.U. ,nga Lipjani,të cilën me autorizim e përfaqëson Q.R. ,av.nga Lipjani,ndaj debitorit Komuna e Lipjanit,për shkak të realizimit të kredisë në të holla,në shumë prej 377,00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores të ushtruar përmes përfaqësuesit të saj Zyrtari i lartë ligjor B.K. , kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, PPP.nr.59/2020, i datës 31.05.2021, me datë **19.05.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të debitores Komuna e Lipjanit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, **PPP.nr.59/2020**, i datës **31.05.2021**, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, me aktvendimin PPP.nr.59/2020, i datës 31.05.2021, është refuzuar si i pabazuar prapësimi i parashtruar i debitores Komuna e Lipjanit , i paraqitur kundër Urdhërit për përmbarim P.nr.325/20, të dt. 08.10.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësuesit të tij B.K., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, me pretendimin se Urdhëri për Përmbarim është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, meqë, është dashur të pritet shqyrtimi i ankesës nga Inspektoriati i Punës i shkallës së dytë, e gjithashtu edhe me pretendimin referuar nenit 90, par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, kontrata kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës, te cilët kanë marrë përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratë kolektive, e që rrjedhimisht dokumenti përmbarimor është në kundërshtim me nenet 22, 24, 27, 38 dhe 43 të LPP-së, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, me ankesën e ushtruar ka propozuar që të aprovohet ankesa e debitorit Komuna e Lipjanit dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan PPP.nr. 59/20, dt: 31.05.2021.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori përmes të autorizuarit të tij av.Q.R. nga Lipjani , me propozim që ankesa e përfaqësuesit të debitorit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, fillimisht duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore dhe funksionale, konstaton se ka kompetencë lëndore bazuar në nenin 3 par.2 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore e gjithashtu edhe funksionale ku përcaktohet se në shkallën e dytë në procedurën përmbartimore vendos gjyqtari individual i gjykatës së shkallës së dytë, për vendosje sipas ankesës së ushtruar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika (b) të LPK-së, në lidhje me nenin 17 të LPP-së, gjeti se:

-Ankesa e përfaqësuesit të debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 06.10.2020, ka paraqitur propozim pranë organit përmbartues të përmbartuesi privat B. B.T. „në Ferizaj për caktimin e përmbartimit në bazë të vendimit të inspektoratit të punës.

Organi përmbartues me urdhrin P.nr.325/20, i datës 08.10.2020 e ka lejuar përmbartimin.

Debitori, pas pranimit të urdhërit për përmbartim, përmes përfaqësuesit të tij B. K., ka ushtruar prapësim pranë Gjykatës së shkallës së parë me propozim që Gjykata ta aprovojë prapësimin ndërsa urdhrin e përmbartuesit privat ta anulojë-shfuqizojë.

I autorizuari i kreditorit av.Q. R., brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me propozimin që i njëjti të refuzohet i pabazuar dhe vërtetohet Urdhëri për Lejimin e Përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.59/2020, i datës 31.05.2021 e ka refuzuar si të pabazuar, prapësimin e përfaqësuesit të debitorit, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimin të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të të autorizuarit të kreditorit, si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se Urdhri për përmbartim është marrë dhe caktuar në bazë të titullit përmbartues konform nenit 21 dhe 22.1 nën par.1.2 të LPP-së, i cili është i pambarueshëm konform nenit 24 paragrafi 3 dhe 5 të njëjtit ligj, dhe se prapësimi i debitorit i parashtruar kundër urdhërit për përmbartim, është i pa bazuar, për faktin se nuk përmbushen asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, sepse debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është përcaktuar me nenin 69 par.4 të LPP-së, e që për rrjedhojë nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet për anulimin apo shfuqizimin e urdhërit për caktimin e përmbartimit.

Gjykata e Apelit, vendimin e gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Në ankesën e paraqitur debitori, përmes përfaqësuesit të tij B.K., pretendon se urdhëri për përmbartim është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, sepse është dashur që të pritët shqyrtimi i ankesës nga Inspektorati i Punës në shkallë të dytë. Debitori në ankesë shton se sipas nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, Kontrata Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën e tillë kolektive.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mësipërme të parashtruar nga ana e përfaqësuesit të debitorit, vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara për arsye se kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe atë për faktin se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të dokumentit përmbarrues –vendimit administrativ i përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të këtij ligji i cili përcakton se: **“1. Dokumente përmbarruese janë:1.2. vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia);”**, po ashtu Ligji për Procedurën Përmbarrimore e përcakton edhe çka konsiderohet vendim administrativ ku neni 23 par.2 përcakton se: **“2. Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrative, konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”**, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita, andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të debitorit se është dashur të pritej, derisa organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës të marrë vendimin lidhur me ankesën e ushtruar, as ky pretendim nuk qëndron për arsye se duke u bazuar në nenin 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, ankesa e ushtruar kundër vendimit të Inspektoratit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin, kështu që nuk ekziston asnjë pengesë ligjore që vendimi në fjalë të mos përmbarrohet.

Kjo Gjykatë, vëren se vendimi i organit administrativ, Inspektorati i Punës nuk e përmban klauzolën e përmbarrueshmërisë, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se kjo nuk paraqet shkak që vendimi si i tillë të mos ekzekutohet sepse në rastin konkret përshtatshmërisht do të aplikohen edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative.

Neni 24 par.3 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcakton se: **“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”**, ndërsa neni 144 i Ligjit për Procedurën Administrative paragrafi 1, nënpar.1.4 përcakton se: **“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.4 njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji”**.

Në rastin konkret, vendimi në bazë të të cilit është bërë propozimi për përmbarrim, në dispozitivin e këtij vendimi, pala është njoftuar se ankesa nuk e pezullon ekzekutueshmërinë e aktit administrativ, andaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të mos u lejuar ekzekutueshmëria e aktit administrativ në fjalë, për shkak se gjen mbështetje të plotë në dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu nuk qëndron as pretendimi i përfaqësuesit të debitorit se Kontrata Kolektive vlen vetëm për ata punëmarrës dhe punëdhënës, të cilët i marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratë kolektive, për faktin se mos nënshkrimi drejtpërdrejt i debitorit në Kontratën Kolektive nuk e liron të njëjtën nga obligimi, pasi në emër të debitorit, palë kontraktuese ka qenë Ministria e Arsimit, dhe se Kontrata në fjalë prodhon efekt juridik ndaj të gjithë punëdhënësve në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës. Koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e debitorit me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk afekton në të drejtën e kreditorit dhe detyrimin e debitorit.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsye, të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbaruar, Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, andaj e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.6770/21, me datë 19.05.2022

Gjyqtari Individual
Besnik Feka